

**MASAT PËR
IMPLEMENTIMIN EFEKTIV TË
PARIMEVE BANGALORE TË SJELLJES SË GJYQËSORIT
(Masat e implementimit)**

**Miraturar nga Grupi i Integritetit Gjyqësor
në mbledhjen e mbajtur në
Lusaka, Zambia**

21 dhe 22 Janar 2010

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
-------------	---

Pjesa e parë

Përgjegjësitë e Gjyqësorit

1. Formulimi i Deklaratë së Parimeve të Sjelljes së Gjyqësorit	6
2. Aplikimi dhe Zbatimi i Parimeve të Sjelljes së Gjyqësorit	6
3. Caktimi i rasteve	7
4. Administrimi i gjykatave	7
5. Qasja në Drejtësi	8
6. Transparenca në ushtrimin e Zyrës së Gjyqësorit	9
7. Trajnime Gjyqësore	10
8. Opinionet këshillëdhënëse	11
9. Imuniteti i Gjyqtarëve	11

Pjesa e dytë

Përgjegjësitë e Shtetit

10. Garantimi Kushtetues i Pavarësisë së Gjyqësorit	12
11. Kualifikimet për Zyrën e Gjyqësorit	13
12. Emërimi i Gjyqtarëve	13
13. Mandati i Gjyqtarëve.....	14
14. Kompensimi i Gjyqtarëve	15
15. Disiplinimi i Gjyqtarëve	15
16. Shkarkimi i Gjyqtarëve nga detyra	16
17. Buxheti i Gjyqësorit	16
Përkufizimet	17

HYRJJE

Parimet Bangalore të Sjelljes së Gjyqësorit identifikojnë gjashtë vlera thelbësore të drejtësisë - Pavarësinë, Paanësinë, Integritetin, Korrektësinë, Barazinë, Kompetencat dhe Kujdesin e duhur. Ato kanë për qëllim krijimin e standardeve të sjelljes etike të gjyqtarëve. Janë të dizajnuara për të siguruar udhëzime për gjyqtarët në kryerjen e detyrave të tyre gjyqësore dhe t'i japin Gjyqësorit një kornizë në rregullimin e sjelljes së gjyqtarëve. Ato kanë gjithashtu për qëllim të ndihmojnë anëtarët e ekzekutivit dhe legjislativit, avokatët dhe publikun në përgjithësi, për të kuptuar më mirë rolin e gjyqësorit, dhe për të ofruar komunitetit një standard me të cilin do të masin dhe vlerësojnë performancën e sektorit gjyqësor. Komentari mbi Parimet e Bangalores ka për qëllim të kontribuojë në një kuptim më të mirë të këtyre parimeve.

Seksioni mbi "Zbatimin" në Parimet Bangalore të Sjelljes së Gjyqësorit thekson se:

Për shkak të natyrës së zyrës së gjyqësorit, masat efektive do të miratohen nga gjyqësori kombëtarë për të ofruar mekanizma për zbatimin e këtyre parimeve, në qoftë se mekanizma të tillë tashmë veç nuk ekzistojnë në juridiksionin e tyre.

Në disa juridiksione mekanizmat dhe procedurat tashmë ekzistojnë, që janë krijuar me ligj ose me rregulla të gjykatës, për të vendosur standardet etike të sjelljes së gjyqtarëve. Në të tjerat ato nuk janë. Si rrjedhim, kjo deklaratë e masave është ofruar nga Grupi i Integritetit Gjyqësor si udhëzim ose standard për zbatimin efektiv të Parimeve Bangalore. Kjo deklaratë është në dy pjesë. Pjesa e parë përshkruan masat që janë të nevojshme të miratohen nga gjyqësori. Pjesa e dytë përshkruan rregullimet institucionale që janë të nevojshme për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit dhe të cilat janë ekskluzivisht brenda kompetencave të shtetit. Përderisa pavarësia e gjyqësorit është pjesërisht një gjendje shpirtërore e anëtarëve të gjyqësorit, Shtetit i kërkohet të krijojë një grup të marrëveshjeve institucionale që do të mundësojnë gjyqtarin dhe bartësit e tjerë relevant të shijojnë atë gjendje shpirtërore. Mbrojtja e administrimit të drejtësisë nga ndërhyrja apo ndikimi politik nuk mund të arrihet vetëm nga gjyqësori. Përderisa është përgjegjësi e gjyqtarit që të jetë i lirë ndaj lidhjeve të papërshtatshme me ekzekutivin dhe legjislativin, është përgjegjësi e Shtetit të krijojë rregullimet institucionale që do të sigurojnë pavarësinë e gjyqësorit nga dy degët e tjera të Qeverisë¹

¹ Në Komentin e Përgjithshëm nr.32 (2007), Komiteti i të Drejtave të Njeriut thotë se kërkesa e pavarësisë në nenin 14 (1) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike i referohet në veçanti, me procedurën dhe kualifikimet për emërimin e gjyqtarëve, dhe garancitë që lidhen me sigurinë e qëndrimit të tyre në detyrë deri në moshën e pensionimit të detyrueshëm ose skadimit të mandatit të tyre, aty ku ekzistojnë, kushtet që rregullojnë promovimin, transferimin, pezullimin dhe ndërprerjen e funksioneve të tyre dhe pavarësia aktuale e Gjyqësorit nga ndërhyrjet politike nga dega e ekzekutivit dhe legjislativit. Rrjedhimisht, Shtetet duhet të marrin masa të veçanta që garantojnë pavarësinë e Gjyqësorit, mbrojtjen e gjyqtarëve nga çdo formë e ndikimit politik në marrjen e

Në hartimin e kësaj deklarate masash, referencë është bërë në disa kushtetuta kombëtare dhe në iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar që ato pasqyrojnë një konsensus të gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar.

- a) Draft Parimet mbi Pavarësinë e Gjyqësorit ("Parimet e Sirakuzës"), të formuluar nga një komitet përfaqësues i ekspertëve më 1981;
- b) Standardet Minimale të Pavarësisë Gjyqësore miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve në vitin 1982;
- c) Parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit 1985;
- d) Draft Deklarata Universale për Pavarësinë e Drejtësisë 1988 ("Deklarata Singhvi");
- e) Rekomandimi Nr.R (94) 12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve, vitit 1994;
- f) Deklarata e Pekinit e Parimeve të Pavarësisë së Gjyqësorit miratuar nga një konferencë e Krerëve të Gjyqtarëve të rajonit të Azisë-Paqësorit në 1995;
- g) Karta Europiane mbi Statutin e Gjyqtarëve të miratuara në vitin 1998;
- h) Karta Universale e Gjyqtarit e miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve në 1999;
- i) Platforma e Shtëpisë Latimer në Epërsinë Parlamentare dhe Pavarësia Gjyqësore për Komonuelthit e miratuar në vitin 2001;
- j) Opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europeanë (KKGjE):

Opinion Nr.1 (2001): Standardet lidhur me Pavarësinë e Gjyqësorit dhe mosheqjen e gjyqtarëve;

Opinion Nr.2 (2002): Parimet dhe Rregullat që drejtojnë sjelljen Gjyqtarëve profesional, në veçanti Etikës, Sjelljes së papajtueshme dhe Paanësisë;

Opinion Nr.3 (2003): Shërbim Trajnimi i duhur fillestar për Gjyqtarët në nivelet kombëtare dhe evropiane;

Opinion Nr.10 (2007): Një Këshilli Gjyqësor.

vendimeve të tyre përmes kushtetutës ose miratimin e ligjeve duke krijuar procedura të qarta dhe kritere objektive për emërimin, shpërblimin, mbajtjen në punë, promovimin, pezullimin dhe shkarkimin e anëtarëve të gjyqësorit dhe sanksioneve disiplinore të marra ndaj tyre.

- k) Blantyre për sundimin e ligjit/ndarjes së pushteteve komunikatë e lëshuar nga përfaqësuesit e të tri degëve të Qeverisë në rajonin e Komunitetit të Zhvillimit Jug-Afrikan (SADC) në vitin 2003;
- l) Deklarata e Kajros mbi Pavarësinë Gjyqësore miratuar nga pjesëmarrësit e Konferencës së Dytë të Drejtësisë Arabe mbajtur në vitin 2003;
- m) Deklarata Suva mbi Parimet e Pavarësisë Gjyqësore dhe Qasja në Drejtësi miratuar në një seminar gjyqësor në vitin 2004.
- n) "Çështjet e drejtësisë" - raporti i Këshillit Irlandez për Liritë Civile të Pavarësisë, Përgjegjësitë dhe Gjyqësori Irlandez, 2007;
- o) Koment i Përgjithshëm Nr.32 (2007) i Komitetit të të Drejtave të Njeriut në nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.
- p) Raporti i Komisionit të Venecias për Emërime Gjyqësore, 2007;
- q) Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Draft Udhëzuesi për Forcimin e integritetit dhe kapacitetit gjyqësor, Tetor 2009.

Pjesa e parë

PËRGJEGJËSITË E GJYQËSORIT

1. Formulimi i Deklaratës së Parimeve të Sjelljes së Gjyqësorit

- 1.1. Gjyqësori duhet të miratojë një deklaratë të parimeve të sjelljes së gjyqësorit, duke marrë në konsideratë parimet Bangalore të Sjelljes së Gjyqësorit.
- 1.2. Gjyqësori duhet të sigurojë që deklarata e tillë e parimeve të sjelljes së gjyqësorit është shpërndarë në mesin e gjyqtarëve dhe në komunitet.
- 1.3. Gjyqësori duhet të sigurojë që etika gjyqësore, bazuar në deklaratën e tillë të parimeve të sjelljes së gjyqësorit, janë një element integral në trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve.

2. Aplikimi dhe Zbatimi i Parimeve të Sjelljes së Gjyqësorit

- 2.1. Gjyqësori duhet të konsiderojë krijimin e komitetit këshillëdhënës të etikës gjyqësore për gjyqtarët prezent dhe / ose ata në pension për të këshilluar anëtarët e saj drejtë në sjelljet e parashikuara apo të propozuara të tyre në të ardhmen².
- 2.2. Gjyqësori duhet të konsiderojë krijimin e komitetit të besueshëm, të shqyrtimit etik të gjyqësorit për të marrë, bërë hulumtime, zgjidhur dhe për të përcaktuar ankesat e sjelljes jo etike të anëtarëve të gjyqësorit ku nuk ekziston dispozitë për referencë të ankesave të tilla para një gjykate. Komisioni mund të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve, por duhet të përfshijë mundësisht përfaqësimit të mjaftueshëm laik për të tërhequr besimin e komunitetit. Komisioni duhet të sigurojë, në përputhje me ligjin, se mbrojtja u ipet ankuesve dhe dëshmitarëve dhe se procesi i rregullt është siguruar tek gjykatësit kundër të cilit është bërë ankesa, me konfidencialitet në fazat paraprake të një hetimi nëse kjo kërkohet nga gjyqtari. Për të mundësuar komisionit që të japë privilegj të tillë mbi dëshmitarët, etj, kjo mund të jetë e nevojshme që ligji të përballojë privilegj absolut ose të kualifikuar për punimet e komisionit.

² Në shumë juridiksione ku komitetet e tilla janë themeluar, një gjyqtar mund të kërkojë mendimin këshillëdhënës në lidhje me drejtësinë e sjelljes së tij ose të saj. Komisioni mund të lëshojë opinione me nismën e vet për çështjet e interesit të gjyqësorit. Opinione adresojnë sjelljet e parashikuara apo propozuara në të ardhmen dhe jo sjelljet e kaluara ose aktuale, përveç nëse një sjellje e tillë ka të bëjë me sjelljen e ardhshme ose është në vazhdimësi. Opinione formale përcaktojnë faktet mbi të cilat opinioni është i bazuar dhe japin këshilla vetëm në lidhje me ato fakte. Ato citojnë rregullat, rastet dhe autoritetet e tjera që mbajnë mbi këshillën e dhënë dhe japin kuotën e aplikueshme të parimeve të sjelljes së gjyqësorit. Opinioni origjinal formal i dërgohet personit që kërkon mendimin, derisa një version i redaktuar i cili lë jashtë emrat e personave, gjykatave, vendeve dhe çdo informacion tjetër që mund të tentojnë të identifikojë personin që bën kërkesën dërgohet në gjyqësor, shoqata të avokatëve dhe biblioteka të shkollave të drejtësisë. Të gjitha mendimet janë vetëm këshilluese, dhe nuk janë të detyrueshme, por respektimi i një opinioni këshillues mund të konsiderohet të jetë dëshmi e besimit të mirë.

Komisioni mund t'i referohet ankesave mjaft serioze, organit përgjegjës për ushtrimin e kontrollit disiplinor ndaj gjykatësit ³

3. Caktimi i rasteve

- 3.1. Emërimi i gjyqtarëve është pjesë e pazgjidhshme e ushtrimit të pushtetit gjyqësor.
- 3.2. Ndarja e punës ndër gjyqtarët e një gjykate, duke përfshirë shpërndarjen e rasteve, duhet rregullisht të kryhet sipas një marrëveshje të paracaktuar sipas ligjit ose duke rënë dakord të gjithë gjyqtarët e gjykatës përkatëse. Marrëveshje të tilla mund të ndryshohen në rrethana të përcaktuara qartë siç është nevoja për të pasur parasysh njohuritë speciale të gjyqtarit ose përvojën. Alokimi i rasteve mundet, si për shembull, të bëhet nga një sistem sipas rendit alfabetik ose kronologjik apo procesit tjetër përzgjedhës të rastit.
- 3.3. Një rast nuk duhet të tërhiqet nga një gjykatës i caktuar pa shkaqe të arsyeshme. Çfarëdo arsye dhe procedurë për tërheqje duhet të bëhet sipas ligjit ose sipas rregullave të gjykatës.

4. Administrimi i Gjykatave

- 4.1. Përgjegjësia për administrimin e gjykatave, duke përfshirë emërimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin disiplinor të personelit të gjykatës duhet të jetë në gjyqësor apo në ndonjë subjekt tjetër në drejtimin dhe kontrollin e tij.
- 4.2. Gjyqësori duhet të miratojë dhe të zbatojë parimet e sjelljes për personelin e gjykatës, duke marrë në konsideratë Parimet e Mirësjelljes për Personelin e Gjykatave të formuluar nga Grupi i Integritetit Gjyqësor në vitin 2005.
- 4.3. Gjyqësori duhet të përpiqet të shfrytëzojë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit me qëllim të forcimit të transparencës, integritetit dhe efikasitetin e drejtësisë.

³ Në shumë juridiksione ku janë themeluar komitete të tilla, ankesat në rastet në pritje nuk janë konsideruar, përveç nëse këto janë ankesa të vonesave të tepruara. Ankesa duhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet, dhe të përfshijë emrin e gjyqtarit, një përshkrim të hollësishëm të sjelljes së supozuar joetike, emrat e dëshmitarëve, si dhe adresa dhe numri i telefonit të parashtruesit të ankesës. Gjykatësi nuk do të mund të jetë i njoftuar për një ankesë, përveç nëse komisioni konstaton se një shkelje e etikës mund të ketë ndodhur. Identiteti i personit që bën ankesën nuk shpalolet tek gjykatësi përveç nëse e pranon ankuesi. Kjo mund të jetë e nevojshme, megjithatë, për ankuesin për të dëshmuar si dëshmitar në rast të seancës. Të gjitha çështjet para komitetit janë konfidenciale. Nëse është përcaktuar se mund të ketë pasur shkelje të etikës, komiteti zakonisht trajton çështjen joformalisht me një formë të këshillimit me gjykatësin. Nëse komiteti lëshon akuzë formale kundër gjykatësit, kjo mund të zhvillojë një seancë dhe nëse konstatohet që akuza të jetë e bazuar, gjykatësit mund ti ipet privatisht një qortim, ose vendos gjyqtarin në një periudhë të mbikëqyrjes e që i nënshtrohet termave dhe kushteve të parapara. Akuzat që komiteti i konsideron mjaft serioze për të kërkuar pensionimin, censurë publike ose shkarkimin e gjykatësit i referohen organit përgjegjës për ushtrimin e kontrollit disiplinor mbi gjykatësin.

- 4.4. Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të veta për të promovuar cilësinë e drejtësisë, gjyqësori duhet që, përmes auditimeve të rastit, anketave të përdoruesve të gjykatës dhe palëve të tjera, diskutime me komitetet e përdoruesve të gjykatave, të përpiqet për të shqyrtuar satisfacionin e publikut lidhur me ofrimin e drejtësisë dhe për të identifikuar dobësitë sistematike në procesin gjyqësor me qëllim të korrigjimit të tyre.
- 4.5. Gjyqësori duhet rregullisht të adresojë ankesat e përdoruesve të gjykatës dhe publikon raportin vjetor të aktiviteteve të tij duke përfshirë vështirësitë e hasura dhe masat e marra për përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë.

5. Qasja në Drejtësi

- 5.1. Qasja në drejtësi ka një rëndësi thelbësore në sundimin e ligjit. Gjyqësori duhet, brenda kufijve të kompetencave të tij, të miratojë procedura për të lehtësuar dhe për të promovuar një qasje të tillë.
- 5.2. Kur nuk ka në dispozicion ndihma të mjaftueshme ligjore, kostot e larta të përfaqësimit ligjor privat e bëjnë të domosdoshme gjyqësorin të marrë në konsideratë, iniciativa si: inkurajimin e përfaqësimit bono pro, të litigatorëve nga profesioni ligjor i litigatorëve të zgjedhur. Emërimi i *amici curiae* (shok i gjykatës), zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe procedurave të drejtësisë së komunitetit, për mbrojtjen e interesave që përndryshe do të ishin të papërfaqësuara në proceset gjyqësore; dhe sigurimin e autorizimeve tek personat e pershtatshëm të pa kualifikuar (duke përfshirë Asistentët Ligjor) për përfaqësimin e palëve pranë gjykatës.
- 5.3. Gjyqësori duhet të vendosë teknika moderne të menaxhimit të rasteve për të siguruar sjellje të rregullt dhe të shpejtë si dhe përmbyllje të procedurave gjyqësore⁴.

⁴ Tradicionalisht, palët në mosmarrëveshjeje të kontrolluar lëvizjen e një rasti, me gjyqtarët dhe personelin e gjykatave që thjesht luajnë rolin e udhëheqësve. Kjo është e njohur tashmë në shumë juridiksione se gjyqësori duhet në mënyrë aktive të monitorojë dhe kontrollojë përparimin e një çështjeje, sidomos në gjykata fillestare, nga institucioni në aktgjykime, duke përfshirë përfundimin e të gjitha hapave të post-aktgjykimeve. Menaxhimi aktiv nga gjykata e progresit të një rasti është projektuar për të inkurajuar drejtësinë, rezolucion të rregullt dhe të shpejtë të kontesteve. Kjo mund të përfshijë çështjen që trajtohet nga i njëjti gjyqtar nga fillimi deri në fund; rregullimin e hershëm të datë së gjykimit pothuajse të pandryshueshëm; vetë gjykatësi duke bërë rregullimin e orarit dhe dhënien e udhëzimeve përkatëse në periudhën paraprake; dhe i njëjti gjyqtar përpiqet për rastin në qoftë se rasti shkon në gjyq. Përfshirja aktive e gjyqtarit mundëson atë për të trajtuar në mënyrë efektive me fushat kritike të procesit gjyqësor, siç janë deklaratat me defekte, zbulim i papërmbajtur i dokumenteve dhe teknika të tjera të përdorura shpesh për të vonuar procedurën. Gjithashtu mund të lehtësojë në vazhdimës seancat dëgjimore të një rasti në vend të seancave të shkurtra dhe jo të plota të shpërndara në disa javë apo muaj.

6. Transparenca në ushtrimin e Zyrës së Gjyqësorit

- 6.1. Procedurat gjyqësore duhet, në parim, të zhvillohen publikisht. Publiciteti i seancave siguron transparencën e procedurave. Gjyqësori duhet të informojë dhe vë në dispozicion të publikut kohën dhe vendin e seancave dhe të sigurojë objekte adekuate për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të interesuar brenda kufijve të arsyeshëm, duke marrë parasysh, ndër të tjera, interesin potencial në rastin dhe kohëzgjatjen e séances ⁵
- 6.2. Gjyqësori duhet të promovojë në mënyrë aktive transparencën në ofrimin e drejtësisë, dhe të sigurojë që, subjekti i mbikëqyrjes gjyqësore, publiku, mediat dhe përdoruesit e gjykatës kanë qasje në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me procedurat gjyqësore, si ato në pritje poashtu edhe ato të përfunduarat, qoftë në faqen e internetit të gjykatës ose nëpërmjet shënimeve të përshtatshme dhe të qasshme. Informacioni i tillë duhet të përfshijë gjykime të arsyetuara, deklarata, mocionet dhe provat, por që dëshmitë nën betim apo dokumentet dëshmuese të cilat ende nuk janë pranuar nga gjykata si provë, mund të përjashtohen.
- 6.3. Për të lehtësuar qasjen në sistemin gjyqësor, gjyqësori duhet të sigurojë standardin, formularët dhe udhëzimet e lehta në përdorim, si dhe informacion të qartë dhe të saktë mbi çështje të tilla si tarifatat e dosjeve, procedurat gjyqësore dhe oraret e seancave dëgjimore të jenë në dispozicion për përdoruesit e mundshëm të gjykatës.
- 6.4. Gjyqësori duhet të sigurojë që dëshmitarët, përdoruesit e tjerë të gjykatës dhe pjesëtarët e interesuar të publikut të kenë qasje në shenja lehtësisht të lexueshme si dhe të kenë të shfaqur udhëzues orientimi të Ndërtesës së Gjykatës. Duhet të sigurohet personel i mjaftueshëm i gjykatës për t'iu përgjigjur pyetjeve përmes shërbimeve të informacionit publik. Ata duhet të jenë në dispozicion në afërsi të hyrjeve të gjykatës. Shërbimet ndja klientëve dhe qendrat e burimeve duhet të ofrohen në një vend të qasshëm. Përdoruesit e gjykatave duhet të kenë qasje të sigurt, të pastërt, të përshtatshëm dhe të lehtë në përdorim e ambienteve gjyqësore me zona të rehatshme të pritjes, hapësirës

⁵ Kërkesa për gjykim publik nuk do të zbatohet për të gjitha procedurat e apelit që zhvillohen në bazë të prezantimeve të shkruara, apo vendime të procedurës paraprake. Neni 14 (1) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike pranon se një gjykatë ka fuqinë për të përjashtuar të gjithë ose një pjesë të publikut për arsye të moralit, rendit publik (ordre public) ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur interesi i jetës private të palëve e kërkon, ose në masën e domosdoshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta publiciteti do të ishte i dëmshëm për interesat e drejtësisë. Përveç rrethana të tilla të jashtëzakonshme, seanca duhet jetë e hapur për publikun e gjerë, përfshirë këtu mediat, dhe nuk duhet, për shembull, të jetë i kufizuar tek një kategori e caktuar personash. Edhe në rastet në të cilat publiku është i përjashtuar nga gjykimi, aktgjykimi, duke përfshirë gjetjet esenciale, provat dhe arsyetimi ligjor duhet të bëhen publike, përveç kur interesi i personave të mitur kërkon ndryshe, ose procedurat kanë të bëjnë me kontestet martesore apo kujdestarinë e fëmijëve.

së duhur publike, dhe pajisje për përdoruesit me nevoja të veçanta, siç janë fëmijët, viktimat, dhe të paaftët.

- 6.5. Gjyqësori duhet të konsiderojë fillimin e programeve të arritura që janë të dizajnuara për edukimin e publikut mbi rolin e sistemit të drejtësisë në shoqëri dhe të trajtojnë paqartësitë e përbashkëta apo idetë e gabuara në lidhje me sistemin e drejtësisë⁶.
- 6.6. Gjyqësori duhet të siguroj qasje dhe asistencën e duhur mediave në kryerjen e funksionit të saj legjitim të informimit të publikut për procedurat gjyqësore, duke përfshirë vendimet në raste të veçanta.

7. Trajnime Gjyqësore

- 7.1. Deri në masën e plotë të kompetencave të tij, gjyqësori vetë duhet të organizojë, të kryejë ose të mbikëqyrë trajnimin e gjyqtarëve.
- 7.2. Në juridiksionet që nuk kanë objekte të përshtatshme të trajnimit, gjyqësori duhet, të kërkojë ndihmën e organeve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe institucioneve arsimore në sigurimin e qasjes në objekte të tilla ose në zhvillimin e kapaciteteve lokale të njohurive.
- 7.3. Të gjithë të emëruarit në zyrën e gjyqësorit duhet të kenë apo të përvetësojnë, para se të marrin detyrat e tyre, njohuri të duhura të aspekteve relevante të ligjeve dhe procedurave substanciale kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjyqtarëve të emëruar në mënyrë të rregullt duhet gjithashtu t'iu paraqitet edhe në fusha të tjera përkatëse veprimtaria gjyqësore siç është menaxhimi i rasteve dhe administrimi i gjykatave, teknologjia informative, shkencat sociale, historia dhe filozofia ligjore, si dhe zgjidhja alternative e kontesteve.
- 7.4. Trajnimi i zyrtarëve gjyqësor duhet të jetë pluralist për të garantuar dhe fuqizuar pikëpamjet e hapura të gjyqtarit dhe paanshmërinë e gjyqësorit.
- 7.5. Përderisa është e nevojshme të krijojmë programe të trajnimit për gjyqtarë mbi baza të rregullta, shërbimi i trajnimit normalisht duhet të bazohet në pjesëmarrjen vullnetare të anëtarëve të gjyqësorit.

⁶ Në një shkëputje nga besimi tradicional se gjyqtarët duhet të mbeten të izoluar nga komuniteti për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre e arritura e gjyqësorit tani përfshin masa proaktive nga gjyqtarët dhe ndërveprimi i drejtpërdrejtë me komunitetet të cilave u shërbejnë. Përvoja tregon se janë rritur njohuritë e publikut rreth ligjit dhe se proceset gjyqësore promovojnë jo vetëm transparencën në gjyqësor por edhe besimin e publikut. Kohëve të fundit qasjet e arritura përfshijnë takimet në komunë, prodhimin e programeve të radios dhe televizionit, dhe shpërndarja e materialeve të ngritjes së vetëdijes siç është udhëzuesit e përdorimit në gjykatë në formën e broshurave të shkurtra që ofrojnë informacion bazë mbi arrestimin, paraburgimi dhe dorëzania, procedurat penale dhe civile, si dhe kontakte të dobishme për viktimat e krimit, dëshmitarët dhe përdoruesit e tjerë.

- 7.6. Kur gjuha e literaturës juridike (p.sh. raportet e ligjit, gjykimet e apelit, etj) është e ndryshme nga gjuha e edukimit ligjor, instruksionet e mëparshme duhet të sigurohen për të dyja palët, avokatët dhe gjykatësit.
- 7.7. Programet e trajnimit duhet të zhvillohen dhe inkurajojnë, një mjedis në të cilin anëtarët e degëve të ndryshme dhe nivelet e gjyqësorit mund të takohen dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre si dhe të sigurojnë njohuri të përbashkëta nga dialogu me njëri-tjetrin.

8. Opinionet këshillëdhënëse

- 8.1. Një gjyqtar ose gjykatë nuk duhet të pëfaqësojë opinione këshilluese të ekzekutivit apo legjislativit, përveç, në bazë të një dispozite të shprehur kushtetuese ose ligjore që lejon atë rrjedhë.

9. Imuniteti i Gjyqtarëve

- 9.1. Gjyqtari duhet të përgjigjet penalisht sipas ligjit për një vepër kryer nga ai apo ajo dhe për këtë arsye nuk mund të pretendojë imunitet nga procesi penal i zakonshëm.
- 9.2. Gjyqtari duhet të gëzojë imunitet personal nga paditë civile për punën në ushtrimin e funksionit gjyqësor.
- 9.3. Mjeti juridik për gabime gjyqësore (qoftë në lidhje me juridiksionin, çështjen ose procedurën) duhet të qëndrojë në një sistem të duhur të ankesave ose të shqyrtimit gjyqësor.
- 9.4. Mjet juridik për lëndimet e shkaktuara për shkak të neglizhencës apo keqpërdorimit të autoritetit nga ana e gjyqtarit duhet të shtrihet vetëm kundër shtetit, pa u drejtuar shteti kundër gjyqtarit.
- 9.5. Pasi që pavarësia e gjyqësorit nuk e bën një gjyqtar të lirë nga përgjegjësia publike, dhe kritika legjitime publike e performancës së gjyqësorit është një mjet për të siguruar përgjegjshmërinë në përputhje me ligjin, gjyqtari duhet përgjithësisht të shmang përdorimin e së drejtës penale dhe mospërfillja e procedurave të kufizojë kritika të tilla gjykatave.

Pjesa e dytë

PËRGJEGJËSITË E SHTETIT

10. Garantimi Kushtetues i Pavarësisë së Gjyqësorit

10.1. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit kërkon që shteti të sigurojë garanci kushtetuese ose me mjete të tjera:

- a) që gjyqësori të jet i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi, dhe se nuk do të ketë pushtet, që do të ushtrohet për të ndërhyrë në procesin gjyqësor;
- b) se secili ka të drejtë të gjykohet me ekspeditën e duhur dhe pa vonesa të panevojshme nga ana e gjykatave të rregullta ose tribunale të themeluara me ligj duke iu nënshtruar ankimit, ose rishikimit nga, gjykatat;
- c) të mos bëhet ad hoc themelimi i tribunaleve të veçanta për të zhvendosur juridiksionin normal dhënë ndryshe në gjykata;
- d) që, në procesin e vendim-marrjes, gjyqtarët janë në gjendje të veprojnë pa asnjë kufizim, ndikim të papërshtatshëm, nxitje, presion, kërcënim apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, apo për çfarëdo arsye dhe të ushtrojnë lirinë e papenguar për të vendosur rastet në mënyrë të paanshme, sipas ndërgjegjes së tyre dhe zbatimin e ligjit me faktet që ata gjejnë;
- e) që gjyqësori të ketë juridiksion, drejtpërdrejt ose me anë të rishikimit, mbi të gjitha çështjet e natyrës gjyqësore dhe që asnjë organ tjetër përveç gjykatave të mund të vendosë përfundimisht juridiksionin dhe kompetencat e veta, të përcaktuara me ligj;
- f) se ekzekutivi do të përmbahet nga çdo veprim apo mosveprim që paraprinë zgjidhjen gjyqësore të një mosmarrëveshjeje ose frustron ekzekutimin e duhur të një vendimi të gjykatës;
- g) që personi i cili ka funksion legjislativ apo ekzekutiv nuk do të ushtrojë, ose të përpiqet të ushtrojë, çdo formë të presionit mbi gjyqtarët, qoftë hapur ose fshehtë;
- h) që pushteti legjislativ apo ekzekutiv i cili mund të ndikojë tek gjyqtarët, kompensimin e tyre, kushtet e shërbimit apo burimet e tyre, nuk do të përdoren me qëllim ose si pasojë e kërcënimeve ose duke sjellë presion mbi një apo më shumë gjyqtar;
- i) që Shteti duhet të sigurojë sigurinë dhe mbrojtjen fizike të anëtarëve të gjyqësorit dhe familjeve të tyre, sidomos në rast të kërcënimeve; dhe
- j) që akuzat për shkelje kundër një gjyqtari nuk do të diskutohen në legjislaturë, përveç nëse ka ndonjë mocion përmbajtësor për largim apo censur të gjyqtarit të cilit iu është dhënë njoftimi paraprak.

11. Kualifikimet për Zyrën e Gjyqësorit

- 11.1. Personat e përzgjedhur për zyrë të gjyqësorit duhet të jenë individë me aftësi, ndershmëri dhe efikasitet si dhe me trajnim të duhur apo kualifikim në drejtësi.
- 11.2. Për vlerësimin e kandidatit për zyrën e gjyqësorit duhet të merret në konsideratë jo vetëm ekspertiza ligjore dhe aftësitë e përgjithshme profesionale të tij apo të saj, por edhe vetëdijesimi shoqëror dhe ndjeshmëria e tij apo saj, cilësitë e tjera personale (duke përfshirë sens të etikës, durim, kortezi, ndershmëri, sens të përbashkët, takt, përlësi dhe përpikëri në orar) si dhe aftësi komunikimi. Bindjet politike, fetare ose bindjet tjera të kandidatit nuk duhet të jenë të rëndësishme, përveç në rastet kur vërtetohet ndërhyrja në performancën e gjyqtarit gjatë kyerjes së të detyrave gjyqësore.
- 11.3. Në përzgjedhjen e gjyqtarëve, nuk duhet të ketë diskriminim mbi baza të parëndësishme. Kërkesa që një kandidat për post gjyqësor të jetë shtetas i vendit në fjalë nuk do të konsiderohet diskriminues për arsye të parëndësishme. Konsideratë e duhur duhet kushtuar sigurimit të një pasqyrimi të drejtë shoqërisë nga gjyqësori, në të gjitha aspektet e saj.

12. Emërimi i Gjyqtarëve

- 12.1. Dispozitat për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen me ligj.
- 12.2. Anëtarët e gjyqësorit dhe anëtarë e komunitetit duhet që secili të luajnë role të përcaktuara në mënyrë të duhur në përzgjedhjen e kandidatëve për zyrat e gjyqësorit.
- 12.3. Për të siguruar transparencë dhe përgjegjësi në këtë proces, kriteret e emërimit dhe përzgjedhjes duhet të bëhen të qasshme për publikun e gjerë, duke përfshirë edhe cilësitë e kërkuara nga kandidatët për poste të larta në gjyqësor. Të gjitha vendet e lira në gjyqësor duhen të shpallen në atë mënyrë ashtuqë të ftojnë aplikacionet, ose nominimet, e kandidatëve të përshtatshëm për emërim.
- 12.4. Një mekanizëm i cili ka marrë mbështetje të veçantë në atë që Shteti të zhvillojë aranzhime të reja kushtetuese, konsiston në krijimin e një Këshilli të Lartë Gjyqësor, me përfaqësim të përzier të gjyqësorit dhe porotës, anëtarësimi i të cilave nuk duhet të dominohet nga afinitetet politike.
- 12.5. Kur një këshill i pavarur apo komision konstituohet për emërimin e gjyqtarëve, anëtarët e saj duhet të zgjidhen në bazë të kompetencave të tyre, përvojës, të kuptuarit e jetës së gjyqësorit, kapacitetin për diskutime në nivelin e duhur dhe vlerësimin për rëndësinë e kulturës së pavarësisë. Anëtarët që nuk janë gjyqtarë mund të zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar apo qytetarët me reputacion dhe përvojë të njohur, e që janë zgjedhur nga një mekanizëm tjetër i përshtatshëm i emërimit.

- 12.6. Promovimi i gjyqtarëve, kur nuk është i bazuar në stazh të punës, duhet të bëhet nga organi i pavarur përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve dhe duhet të bazohet në vlerësim objektiv të performancës së tij ose të saj, duke pasur parasysh ekspertizën, aftësitë, cilësitë personale dhe aftësitë e nevojshme për emërim fillestar.
- 12.7. Procedura në shtete të caktuara për zgjedhjen me rotacion të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose Kryetarit të Gjykatës Supreme, nga radhët e gjyqtarëve të asaj gjykate nga vetë gjyqtarët, nuk është në kundërshtim me parimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe mund të konsiderohet për miratim nga shtetet e tjera.

13. Mandati i Gjyqtarëve

- 13.1. Është detyrë e shtetit që të sigurojë një numër të plotë të gjyqtarëve për të kryer punën e gjyqësorit.
- 13.2. Gjyqtari duhet të ketë të garantuar mandatin me Kushtetutë deri në moshën e pensionimit ose skadimit të mandatit ⁷. Mandati nuk duhet të jetë i ripërtëritshëm përveç nëse ekzistojnë procedura për të siguruar që vendimi për ri-emërim është bërë në bazë të kriterëve objektive dhe në baza meritore.
- 13.3. Angazhimi i përkohshëm ose me gjysëm orari i gjyqtarëve nuk duhet të jetë një zëvendësim për një numër të plotë të gjyqtarëve të përhershëm. Aty ku lejohet me ligj lokal, gjyqtarët e tillë apo ata me gjysëm orari duhet të emërohen mbi kushtet, dhe të shoqëruar nga garancitë për mandatet e tyre ose objektivitet në lidhje me vazhdimin e angazhimit të tyre, e që eliminon, aq sa është e mundur, rreziqet në lidhje me pavarësinë e tyre.
- 13.4. Për shkak se emërimi i gjyqtarëve në periudhë prove mund, nëse abuzohet, të dëmtojë pavarësinë e gjyqësorit vendimi nëse do të konfirmohet apo jo një emërim i tillë duhet të merret vetëm nga organi i pavarur përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve.
- 13.5. Përveç në pajtim me sistemin e rotacionit të rregullt të parashikuar me ligj ose formuluar pas periudhës së konsiderimit nga ana e gjyqësorit, dhe të zbatohet vetëm nga gjyqësori, ose nga një organ i pavarur, gjyqtari nuk duhet të

⁷ Praktikant Kombëtare duket se favorizojnë një moshë të caktuar të pensionimit për gjykatësit e gjykatave superiore. Moshë e paraparë me kushtetutë e daljes në pension për gjyqtarët e gjykatës më të lartë varion nga 62 në Belize, Botsvana dhe Guajana në 65 në Greqi, Indi, Malajzi, Namibi (me mundësi vazhdimi deri në 70), Singapori, Sri Lanka dhe Turqia, 68 në Qipro, 70 në Australi, Brazil Gana, Peru dhe Afrikë të Jugut, në 75 në Kanada dhe Kili. Në disa prej këtyre juridiksioneve (për shembull, Belize dhe Botsvana), megjithatë, ekziston dispozitë për të lejuar një gjyqtar i cili ka mbushur moshën e pensionit për të vazhduar në detyrë "për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të mundësuar atij për të dhënë gjykimin ose për të bërë ndonjë gjë tjetër në lidhje me procedurat që ishin të nisura përpara tij para se ai të arrijë atë moshë".

transferohet nga një juridiksion, funksion apo vend në një tjetër, pa pëlqimin e tij apo saj⁸.

14. Kompensimi i Gjyqtarëve

- 14.1. Pagat, kushtet e shërbimit dhe pensionet e gjyqtarëve duhet të jenë të adekuate, konform statusit, dinjitetit dhe përgjegjësive të zyrës së tyre, dhe duhet të rishikohen periodikisht për ato qëllime.
- 14.2. Pagat, kushtet e shërbimit dhe pensionet e gjyqtarëve duhet të garantohet me ligj, dhe nuk duhet të ndryshohen në dëm të tyre pas emërimit.

15. Disiplinimi i Gjyqtarëve

- 15.1. Procedurat disiplinore kundër një gjyqtari mund të inicohen vetëm në raste të shkeljeve të rënda⁹. Ligji i zbatueshëm për gjyqtarët mund të përcaktojë në mënyrë specifike, sa më shumë të jetë e mundur, sjelljet që mund të rezultojnë në sanksionet disiplinore, si dhe procedurat që duhet ndjekur.
- 15.2. Personi i cili pretendon që ai ose ajo ka pësuar një gabim për shkak të shkeljeve të rënda të gjyqtarit duhet të ketë të drejtë të ankohet tek personi apo organi përgjegjës për iniciimin e masave disiplinore.
- 15.3. Një organ ose person i veçantë duhet të themelohet me ligj me kompetencën për pranimin e ankesave, për marrjen e përgjigjes së gjyqtarit dhe për shqyrtimin në frymën e reagimit të tillë se a ekziston apo jo një rast i mjaftueshëm kundër gjyqtarit për të kërkuar iniciimin e masave disiplinore. Në rast të një përfundimi të tillë, organi ose personi duhet t'ia referojë çështjen autoritetit disiplinor¹⁰
- 15.4. Dicipinimi i gjyqtarëve duhet t'i takojë autoritetit apo tribunalit që është i pavarur nga legjislativi apo ekzekutivi dhe i cili është i përbërë nga gjyqtarët që tanimë shërbejnë apo janë të pensionuar por të cilët mund të përfshijnë në anëtarësimin e tyre edhe persona ndryshe nga gjyqtarët me kusht që personat e tillë nuk janë anëtarë të legjislativit apo ekzekutivit.

⁸ Transferimi i gjyqtarëve është adresuar në disa instrumente ndërkombëtare pasi që ajo mund të përdoret për të ndëshkuar një gjykatës të pavarur dhe kurajoz dhe për të penguar të tjerët në ndjekjen e shembullit të tij apo të saj.

⁹ Sjellja që krijon sanksione disiplinore duhet të dallohet nga rasti i neglizhencës në standardet profesionale. Standardet profesionale përfaqësojnë praktikën më të mirë, të cilat gjyqtarët duhet të synojnë për të zhvilluar dhe për të cilat ata duhet të aspirojnë. Ata nuk duhet të barazohen me sjellje për të justifikuar procedurën disiplinore. Megjithatë, shkelja e standardeve profesionale mund të jetë me rëndësi të konsiderueshme, ku shkelja e tillë supozohet të përbëjë sjellje të mjaftueshme për të justifikuar dhe për të kërkuar sanksionim disiplinor.

¹⁰ Përveç nëse ekziston një filtër i tillë, gjyqtarët mund të përballen me procedurat disiplinore të ngritura në instancën e litigatorëve të pakënaqur.

- 15.5. Të gjitha procedurat disiplinore duhet të përcaktohen duke iu referuar standardeve të përcaktuara të sjelljes së gjyqtarëve, dhe në përputhje me procedurën që garanton të drejtat e plota të mbrojtjes.
- 15.6. Në gjykatë duhet të ketë një shkallë të apelit nga autoriteti disiplinor.
- 15.7. Vendimi përfundimtar në cilëndo procedurë të ngritur kundër një gjyqtari që përfshin sanksionim kundër tij, duhet të publikohet.
- 15.8. Çdo juridiksion duhet të identifikojnë sanksionet e lejueshme sipas sistemit të vet disiplinor, dhe të sigurojë që sanksionet e tilla janë proporcionale, si në përputhshmëri me parimet ashtu edhe me aplikimet e tyre.

16. Shkarkimi i Gjyqtarëve nga detyra

- 16.1. Gjyqtari mund të shkarkohet nga detyra vetëm për shkak të paaftësisë së dëshmuar, kryerjes së një krimi të rëndë, paaftësisë së madhe, ose sjelljes që është haptazi në kundërshtim me pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e gjyqësorit.
- 16.2. Kur legjislatura ka fuqinë e shkarkimit të gjyqtarit, fuqia e tillë duhet të ushtrohet vetëm pas një rekomandimi për këtë qëllim tek autoriteti i pavarur i ngarkuar me fuqinë për të disiplinuar gjyqtarët.
- 16.3. Shfuqizimi i një gjykate në të cilën gjyqtari është anëtar nuk duhet të pranohet si arsye apo rast për shkarkimin e tij. Në rastin kur gjykata është e shfuqizuar ose ristrukturuar, të gjithë anëtarët ekzistues të asaj gjykate duhet të ri-emërohen në zëvendësimin e tij ose të emërohen në një pozitë tjetër gjyqësore me status dhe mandat ekuivalent. Aty ku nuk ka zyre të tillë gjyqësore me status ose mandat ekuivalent, gjyqtarit në fjalë duhet t'i ofrohet kompensim i plotë për shuarjen e vendit të punës.

17. Buxheti i Gjyqësorit

- 17.1. Buxheti i gjyqësorit duhet të krijohet në bashkëpunim me gjyqësorin, kujdes duhet pasur që as autoritetet legjislative e as ato ekzekutive të mos ushtrojnë presion dhe ndikim mbi gjyqësorin gjatë përcaktimit të buxhetit të saj.
- 17.2. Shteti duhet të sigurojë gjyqësorin me fonde dhe resurse të mjaftueshme për të mundësuar çdo gjykatë të kryejë funksionet e veta në mënyrë efikase dhe pa ngarkesë të tepruar pune.
- 17.3. Shteti duhet të sigurojë gjyqësorin me burime financiare dhe burime të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e trajnimit të gjyqtarëve.
- 17.4. Buxheti i gjyqësorit duhet të administrohet nga vetë gjyqësori, ose nga një organ i pavarur i ekzekutivit, dhe legjislatura e cila vepron në konsultim me

gjqësorin. Fondet për gjyqësorin duhet të mbrohen nga tjetërsimi dhe keqpërdorimi.

PËRKUFIZIMET

Në këtë deklaratë të masave zbatuese, kuptimet e mëposhtme do të atribuohen fjalëve të përdorura:

"baza të parëndësishme" është raca, ngjyra, gjinia, feja, origjina kombëtare, kasta, aftësia e kufizuar, mosha, gjendja martesore, orientimi seksual, statusi ekonomik-social si dhe të tjera si shkaqe.

"gjyqtar" nënkupton çdo person që ushtron funksione gjyqësore, megjithatë të caktuara, dhe që përfshin një jursit dhe një anëtar të tribunalit të pavarur.